

VENDIM
Nr. 280, datë 24.6.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 317, DATË 20.8.2021, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME MAT”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 24.6.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 317, datë 20.8.2021, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mat’”.

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mat (UK Mat), me shkresën nr. 277 prot., datë 8.6.2022, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mat” ka paraqitur pranë ERRU kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Mat për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Mat me vendimin nr. 317, datë 20.8.2021, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mat”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuese teknike e shoqërisë UK Mat sh.a., znj. Marisa Mamica, ka mbaruar studimet e larta në “Inxhinieri mjedisi”, dega trajtim ujërash, në vitin 2018.

5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mat sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë, në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Mat është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën “2/b” të vendimit të KKRR-së nr. 317, datë 20.8.2021, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mat”, bëhet ndryshimi, si më poshtë:

“Drejtues teknik: Marisa Mamica.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani